

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“PREMIUM CONTINUITY CONSTRUCTION” Sh.p.k.

Ortakët themelues të Shoqërisë:

Shoqëria “ PREMIUM ALBANIA ” Sh.p.k., me seli në Durres Nikel TAPIZE , me NIPT **K841222030**, e përfaqësuar përfaqësuar nga Ortaku i Vetem dhe administratori Z.Dritan Shehu , bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Ortakut të Vetem të shoqërisë date 01.03.2024 , mbledhur në Tiranë sot më datë 06.03.2024.

VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim harton dhe miraton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj “**PREMIUM CONTINUITY CONSTRUCTION**” Sh.p.k.

1.1 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

NENI 2

Forma juridike

2.1 Shoqëria tregtare “**PREMIUM CONTINUITY CONSTRUCTION**” Sh.p.k. ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

NENI 3

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga “Grumbullimit”Nr 48 fshati Tapizë, Godine dy kateshe,Zona Kadastrale nr.3096,Nj.A.Nikël, Krujë.

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 4 **Vula e shoqërisë**

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 5 **Objekti i Veprimtarisë**

5.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:

a) Aktivitetet në fushën e ndertimit me fondet e veta ose publike të objekteve të ndryshme industriale dhe civile të çdo lloji, për vetë apo për të tretë, private dhe/ose publike, si dhe restaurimi apo riparimi i tyre, marrja e të drejtave dhe çdo lloj avantazhi në çdo lloj forme ligjore që është e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, si dhe shfrytëzimi i të gjitha sipërmarrjeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e mesipërme, në kufijtë e lejuar nga ligji;

Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme, prishje dhe punime në toke të germuara. Prodhim material me baze bitumi, sintetik, druri, metali. Ndertime civile dhe ekonomike. Ndertim rrugë, kategoria IV dhe V, punime të mirëmbajtjes në rrugë, ndertim mbi shtresa gurorë. Ndertim ura dhe vepra arti deri në 10 m.

Ndertime portuale, bankina, banesa, pontile. Ndertim ujësjelles, kanalizime, kanale e impjante vaditjeje, kullimi, sillose, kulla, kulla uji etj, prej betoni dhe metali. Punime të ndryshme në HEC-e të vogla. Import-eksport, tregti me shumicë e pakicë të artikujve elektroshtepiake, ushqimore, industriale, blektorale, bujqësore, pije freskuese, pajisje hidrosanitare, detergjente, fruta perime, artikuj shkollorë, artikuj kozmetik, veshmbathje, konfeksione, pajisje laboratorike e makineri të ndryshme.

Servis kompjuterash, skeleri për ndertim, tregti e prerje xhami.

Shitje makinash të reja e të përdorura. Prodhim dhe tregtim pijesh alkolike.

Hapje agjensi për pasuri të patundshme. Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut. Sinjalistika rrugore jo ndricuese. Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

b) Aktiviteti i sipërmarrjes në ndertim dhe rikonstruksione të objekteve të ndryshme, rrugë, godina banimi të karakterit civil, tregtar e më tej si dhe prodhim, tregtim materiale ndertimi dhe aktivitete të lidhura me ndertimin. Kryerja e investimeve në të gjitha fushat dhe kryesisht për ndertime civile, industriale, turistike, në infrastrukture etj. Ndertime të ndryshme të çdo lloji.

Realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakerive, shoqërive të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjislacioni Shqiptar, me persona fizike dhe juridike, shqiptare ose të huaja

c) Kryerja e shërbimeve të projektimit, studimit, zbatimit, montimit, supervizimit, kolaudimit për punime ndertimi dhe infrastrukture; Projekte të të gjitha llojeve në ndertim, infrastrukture, hidroenergjitik, vepra arti dhe arkitekture. Kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm në funksion të veprimtarisë së saj.

d) Blerjen, shitjen marrjen dhe dhenien me qera të pasurive të palujtshme; ndertimeve civile, ndertim impiantesh për prodhim të lendeve të para, materiale/produkte për ndertim. Asistencë



teknike, per projektim, drejtim. punime ndertimi, supervizim, kolaudim objektesh; veprimtari transporti per material ndertimi e mallra.

e) Kryerja e veprimtarise tregtare import -eksport per materialet e ndertimi, artikuj industrial etj. Pjesmarrje direkte ose indirekte edhe ne shoqeri e ndermarrje qe kane veprimtari te ngjashme me te.

5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 6 ***Kohëzgjatja e Shoqërisë***

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 7 ***Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat***

7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 lekë (njëqint mijë lekë).

Shoqëria “ PREMIUM ALBANIA” Sh.p.k. , zotëron një kuotë me me vlerë 100.000 lekë (njëqint mijë lekë), që përfaqëson 100 % (njëqint përqint) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

7.2 Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri, sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit, ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesëtueshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

7.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8 **Organet e Shoqërisë**

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9 **Administratori**

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.



9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Dritan Shehu , lindur në Caje Kukës, më 01.03.1968, banues në Tiranë, mbajtës ID. Nr.BD7391992 dhe Nr.Personal G80301081A.

9.3 Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë një administrator të dytë me vendim të saj.

NENI 10 **Dispozita të fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 11 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Ky Akt themelimi përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES
Shoqëria "PREMIUM ALBANIA"
Përfaqësuar nga administratori dhe ortakët i vetëm
Z. Dritan Shehu




